

MERITA SAUKU BRUCI

**QASJE VARIANTISTIKE NDAJ NJË KËNGE POPULLORE
ARBËRESHE: “SHKOJ NJË TRIM KA NJË RUÇ”**

Arkivi i Institutit të Gjuhësisë dhe i Letërsisë (Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë) ruan ndër të tjera edhe *fac simile* të dorëshkrimeve të shkrimtarëve arbëreshë, dhuruar ndër vite nga biblioteka apo studiues të ndryshëm. Nën siglën GJ/5, nr. 129 (arka 4, kutia 1) mund të njihemi me dorëshkrime të Bilotës, Krispit, Kamardës, Mickel Zanfino Bushatit, Varibobës, Bafës, Santorit, Serembes. Rruga që kanë ndjekur këto *fac simile* nis nga Biblioteka Mbretërore e Kopenhagenit ku ndodhen origjinalet¹, kalon nga Prishtina, për të përfunduar në arkivin e IGJL. Në faqet 429-430 të këtij blloku ku janë lidhur dorëshkrimet e mësipërme, hasëm një këngë popullore arbëreshe pa titull (*cynycy*), por vargu i parë i së cilës është: *shcoi gny trim ca gny rugh*. Kënga është e plotë (VP). Ndërsa në faqen 432 të bllokut të sipërpërmendur hasëm një variant tjetër të po kësaj kënge, por të paplotë (VPP). Indikacioni përputhet me përshkrimin e dhënë nga Mandalà, sipas klasifikimit bërë nga Gangale²:

Për dikë që ka lexuar me vëmendje *Rapsodie di un poema albanese* të De Radës, nuk mund t'i ketë shpëtuar shënimi që ky i fundit bën për këngën në fjalë:

“Mio Santori,

Jer sera ricevei i due canti popolari che mi rimetteste: Shkōj një trim k̄a një rûg e Ajo zonja e r̄e e Gjik̄ës, il quale ultimo è per la mia raccolta oggi un prezioso regalo; oggi che una figlia dei Gjicca albanesi, nata ne'

¹ Lidhur me korpusin danez të dorëshkrimeve origjinale të Santorit shih për më shumë: M. Mandalà, *Për botimin e veprës letrare të Françesk Anton Santorit. Disa probleme ektotike paraprake*. në “Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe”, Tiranë, botimet Naimi, 2012, f. 149 -180.

² “Theka. III. 17. β me titullin “Frag. Lyricum Antonii Santorii. Domi poetae Radhae repertum” Gangale ka klasifikuar një fletore me format 16,5 x 23cm me gjithsej 7 karta, të shkruara nga të dyja anët përveç fletës së fundit që është e bardhë. Fletët përmbajnë një numërtim joautograf me laps nga 1 deri në 7. Teksti i shkruar në dy kolona përbëhet nga pesë krijime poetike, katër nga të cilat mbajnë titullin “Cynycy” ndërsa njëra “Pirati”. Po aty, f. 166.

principati rumeni, Dora d'Istria (principessa Coltzof Massalsky) attrae a sè gli sguardi simpatici della colta Europa"³

A mund të ishte kjo këngë ajo për të cilën bën fjalë De Rada? Nëse po, përse varianti i De Radës ndryshon në shumë elemente prej atij të Santorit?

Santori dhe kontributi i tij në mbledhjen e këngëve popullore

Pamë më lart se De Rada pohon vetë në botimin e *Rapsodive* që Santori i ka dërguar dy këngë dhe ai i ka përfshirë⁴. A është angazhimi dhe bashkëpunimi i tyre i parë dhe i vetëm në këtë drejtim?

Dorëshkrime të Santorit që kanë mbërritur deri në ditët tona dëshmojnë për angazhim të gjatë e të kahershëm të tij. Mandalà konfirmon që në Bibliotekën Mbretërore të Kopenhagenit, përsëri nën klasifikimin e Gangales, në Theca. III. 17. γ.2 gjendet një fletore (me format 18 x 24,5 cm, me gjithsej 22 fletë, e cila përmban një variant paraprak pune hartuese e shkrimi të teksteve të 17 këngëve (me gjasë faza të veçanta të punës së Santorit për mbledhjen e *Rapsodive* santoriane)⁵. Përmbajnë tekste që rrjedhin në dy kolona dhe vetëm në shqip, të tjera edhe me version italisht ose vetëm versionin italisht dhe me ndërhyrje ndreqëse nga ana e autorit. (Kënga jonë *shkoj një trim ka një ruç* nuk gjendet në këtë grup tekstesh).

Ndërsa Theca III.5. β.3 përmban ndër të tjera në fletët 3v-15r rreth 41 këngë. Sipas Mandalàs: "shënimet mbi shpërndarjen dhe rendin e lëndës dëshmojnë se Santori synonte t'i jepte veprës një strukturë që duhej të përfaqësonte në mënyrë organike "Poemën" e madhe kombëtare shqiptare, atë "Kalevala" arbëreshe që asokohe rrekeshin të krijonin edhe Jeronim de Rada dhe e Nicolò Jenò de' Coronei"⁶. (Kënga jonë *shkoj një trim ka një ruç* nuk gjendet në këtë grup tekstesh).

Variantin e plotë të këtyre rapsodive e gjejmë në fash. γ.3a, Theca III 17, fl. 1-120. Fletore me format 20,6 x 25,4 cm, me 140 fletë, të

³ Për të lexuar letrën në plotninë e saj shih: Girolamo De Rada, *Rapsodie di un poema albanese raccolto nelle colonie del napoletano*. Firenze, Tipografia di Federigo Bencini, 1866, f. 79 - 80.

⁴ Botimin e parë të kësaj kënge nga De Rada e gjejmë me nr. XIII në f. 83-84 të *Rapsodi të një poeme shqiptare* (RPA). De Rada e ribotoi këtë këngë me pak ndryshime në *Biblioteca Albanese*, *Rapsodie Nazionali*, Libro Terzo, Appendice al *Fiamuri Arbërit* (1883-1887). Kënga në këtë ribotim (RN) mban nr. IX dhe gjendet në f. 81-82 të këtij botimi.

⁵ Po aty, f. 167.

⁶ Po aty, f. 159.

numërtuara me shifra arabe autografe. Sipas përshkruesit të fondit, Mandalà-s, kjo “fletore përmban tekstet e këngëve dhe rapsodive që Santori rishkroi me pak ndërhyrje ndreqëse, që shënojnë një fazë të re rikopjimi, duke ndjekur strukurën e përgjithshme të varianteve të sipërpërmendura. Tekstet shqip dhe italisht janë vendosur në dy kolona, të parat majtas të dytat djathtas”⁷. Bëhet fjalë për 66 këngë. (Kënga jonë *shkoj një trim ka një rugh* nuk gjendet në këtë grup tekstesh). Fac-similet e dorëshkrimeve të këtij grupi këngësh gjenden edhe në arkivin e IGJL, Tiranë. Përputhet ky fakt edhe me pohimin e vetë Santorit në 1869, kur në një letër dërguar De Radës lexojmë se: [...] *Intreqa mpero, ngjata e vura mbë drit më të shkëllqeme, gjashtdhët o më kënkashit katundare që bën’e tipografisëtin ti...*⁸

Vetë De Rada pohon në parathënien e ribotimit të rapsodive se: “*Për s’prasmì pata njëzet përtejote t’mbjedhura prej Frat’ Anton Santori. Po pat [t’] veja tue goditur me i nxierr të shtuamet, i ndihur prej të tjer shemblëtire kë kishnja edhe prej gjëje kë kultonjë se i këntonej zonja mëm të mī vëllezrvë te djepi*”⁹.

Më 1893, në një letër drejtuar një tjetër personaliteti të rëndësishëm, kontit Angelo De Gubernatis, glotolog, pikë e rëndësishme referimi edhe për vetë De Radën deri në atë masë sa e quan “il mio angelo protettore”, lexojmë se Santori ftohet nga De Rada të bashkëpunojë në projektin *Folclore d’Italia*. Bëhet fjalë për një projekt-iniciativë të ndërmarrë nga Anxhelo de Gubernatis për të mbledhur folklorin italian e ndërmjet të tjerash edhe atë të arbëreshëve të Italisë. Vetë De Rada sheh një mundësi të rigjallërimit të ëndrrës së tij të kahershme dhe e informon kontin se ka ftuar, ndërmjet shumë miqve të tjerë edhe “*il grande nostro poeta albanese Fra Antonio Santori, ora afflitto parroco d’un povero villaggio*”¹⁰. Dy vite më vonë, pra një vit pas vdekjes së Santorit, De Rada do t’i shkruante kështu A. De Gubernatis:

⁷ Po aty, f. 168.

⁸ Letër e Santorit dërguar De Radës, 16 prill 1869, AQSH, F. 24, D. 54/9, fl. 44.

⁹ G. De Rada, *Biblioteca Albanese*, Rapsodie Nazionali, Prefazione, Appendice al *Fiamuri Arbërit* (1883-1887), f. 2 - 3.

¹⁰ Shih për më shumë: Italo Costante Fortino, “Girolamo De Rada ad Angelo De Gubernatis” në përmbledhjen *Omaggio a Girolamo De Rada, Microprovincia*, gennaio dicembre 2003. n. 41. f. 179 - 255. Citimi është shkëputur nga letra e De Radës dërguar A. de Gubernatis nga Maqi (Macchia Albanese) më 5 shtator 1893. Po aty, f. 219.

“Ho creduto sottometterLe il mio Prologo allo “Scanderbegh” che solo col “Milosao” a un principio, medio e fine, e solo de’ miei conati che forse Ella non ebbe; e poi fra tutti è un dramma del Padre Fra Antonio Santori, nome soave, morto al 7 settembre dell’anno scorso, poeta grande.”¹¹

Vështrim variantistik i këngës

Në këtë kumtesë mëtojmë një qasje variantistike ndaj problemit, duke shuar njëherazi kuriozitetin e lexuesve, duke e sjellë këtu këngën në plotninë e vet sipas variantit të mbledhur/ shkruar/përpunuar nga Santori.

Diskutimi nëse është një këngë popullore apo krijim i mirëfilltë i Santorit meriton një analizë. De Rada e përcakton si një *këngë popullore* (canto popolare) apo *rapsodi*¹² atë që ka marrë prej Santorit duke e përjashtuar faktin që është një krijim i mirëfilltë i tij. Edhe vetë Santori e ka emërtuar *kënëkë / kënëkë katundare* një tipologji të tillë kënge. Po sa burimore dhe sa e pastër (*genuina* në termin që kanë përdorur autorët e Rapsodive) është ajo? Na duhet të kthehemi prapa në kohë e të qëmtojmë në botimet e ndryshme të këngëve popullore arbëreshe para botimit të *Rapsodive* deradiane nëse gjejmë ndonjë simotër të saj. Në kërkimet tona të deritanishme nuk e kemi hasur si këngë¹³. Ndërkohë që kjo këngë,

¹¹ Po aty, f. 227.

¹² Shkruan De Rada në komentin që paraprin këngën e XIII: “ In questa simbolica rapsodia il poeta, forse scoraggiato da’ funesti aspetti della guerra, presentisce alcun finale terribile risolvimento, che adombra nel fato triste della vita universale”. Girolamo De Rada, *Rapsodie di un poema albanese...*, vep. e cit., f. 83.

¹³ Shih për më shumë: *Canti popolari albanesi delle colonie d’Italia*. Pubblicati da un manoscritto della prima metà del secolo XVIII con traduzione juxtalineare da Michele Marchianò. Foggia, Tipografia Francesco Paolo De Nido, 1908; Giuseppe Ferrari, *Canti albanesi*, Raccolta di Michele Bellusci del ’600, Bari, Adriatica Editrice, 1963; Giuseppe Schirò, *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, MCMXXIII; *Appendice al saggio di gramatologia comparata sulla lingua Albanese*, per Demetrio Camarda, Prato, Tip. F. Alberghetti e C, 1866; Jeronim De Rada, *Vepra letrare I, Këngët para Millosaut-I canti premilosaici (1833-1835)* Sprovat e para poetike të Jeronim De Radës. Botim kritik e përkthime italisht përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë, 2014. Një variant rapsodish të Santorit, dorëshkrimet e të cilave sipas kuratorit të tyre gjenden në bibliotekën qytetëse të Kozences mund të gjenden të publikuara në një botim elektronik: Opere di Francesco

mbështetur vetëm mbi variantin e rapsodive të De Radës ka njohur edhe ribotime të tjera, kritike apo divulgative qofshin¹⁴. Edhe diçka tjetër. Përmbajtja e këngës të ngjason më tepër me një traditë gojore jo të kënduar por me një përrallë të treguar dhe nuk mund ta klasifikosh në një tematikat apo motivet¹⁵ që kanë përcaktuar studiuesit e letërsisë apo të folklorit¹⁶. (Anon kryesisht tek përrallat mbi fatin, profecia e një vdekjeje të parakohshme, shpirti që është i lidhur me pëllumbin). Kjo lirikë familjare është ndërtuar mbi një strukturë dialoguese, si shumë nga këngët e tjera të rapsodive, mbushur plot metafora e krahasime. Një lidhje e rastësishme mes dy të rinjsh, e cila kërkon të zyrtarizohet me detyrim nga e ëma e vajzës sjell pasoja tragjike në ardhmërinë e tyre.

Momenti i njohjes së dy të rinjve ndodh në një rrugë fshati. Djaloshi i ri endet i patrazuar rrugëve të tij me një frushërëz në dorë (*baketëzë* VPP, *frushërëz* RPA, *thupërëz* RN). Jo më kot është zgjedhur rruga si element i gjeografisë së fshatit. Ajo është vendi ku lindin mëritë e armiqësitë, thashethemet e pengesat familjare në rrugën e dashurisë. Një kundërvënie e pastër kjo me kroin, buzën e lumit, luadhet, hijet e pemëve, si vendshpalljet e dashurisë në traditën e lirikës sonë. Vajza me të cilën ndeshet nuk ka një përcaktim të qartë e të plotë në variantin e De Radës,

Antonio Santori, *Rapsodit*, a cura di Vincenzo Belmonte, botim elektronik, 2013. <http://www.albanologia.unical.it/FrancescoAntonioSantori/Opere/Opere%20varie/2%20Le%20Rapsodie.pdf> etj.

¹⁴ *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar* (1635-1912), vëllimi I, redaktuar nga Qemal Haxhihasani f. 126 - 201; *Qemal Haxhihasani* (përgatitur nga). *Balada popullore shqiptare*, Tiranë, Sh. B. “Naim Frashëri”, 1982; Jeronim de Rada, *Vepra 5 – Rapsodi të një poeme shqiptare*. Mbledhur në kolonitë e rrethit të Napolit. Translitteruar dhe përgatitur për shtyp nga Anton Çeta e Anton Berisha, Prishtinë, Rilindja, 1983, f. 225-226; Jeronim de Rada, *Vepra letrare V, Rapsoditë Kombëtare - Rapsodie Nazionali*, botim kritik i dy varianteve përgatitur nga Fiorella de Rosa, Tiranë, 2014, f. 158-161 dhe 362-364; Ernesto Tocci, “Su alcuni canti popolari inviati da F. A. Santori al De Rada” në *Atti del 2o Seminario internazionale di Studi Albanesi-Aktet e Seminarit të dytë ndërkombëtar për studimet shqiptare*, a cura di Francesco Altimari con la collaborazione di Giovanni Belluscio, f. 18.

¹⁵ Tradizioni orali non cantate-primo inventario nazionale per tipi, motivi o argomenti. Ministero dei Beni Culturali e Ambientali, Roma 1975.

¹⁶ Zeqirja Neziri, *Lirika gojore shqiptare*, Shkup, Interlingua, 2015, f. 70 - 81; Sadri Fetihu, *Balada popullore shqiptare*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000, f. 25 - 46; Veis Sejko, *Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*, Tiranë, Bargjini, 2002, f. 237 -262.

me një term përgjithësues *kopile* RPA, RN. Në variantin e paplotë të Santorit, e me gjasë edhe më i pari i këngës informohemi se ajo është *e bukurëza* VPP. Por vetëm përshkrimi i detajuar *je bardhullore, kuqullore, e bukurë keq, meshollë*, që Santori jep në variantin e plotë të tij justifikon faktin që djaloshi të befasohet nga bukuria e saj dhe të mos i rezistojë tundimit për të ngritur frushërezën e për t'i prekur gërshetin. Ky veprim nuk shpëton pa i rënë në sy së ëmës së vajzës e cila u ndodh në dritare (*dritësore* VP, RPA, RN, *finestërë* VPP).

Ajo e detyron djalin e pasur që të martohet me vajzën e saj të varfër vetëm sepse ia preku gërshetin. Një martesë e padrejtë e nxituar, së cilës djali tenton t'i bëjë bisht duke sjellë argumentin e pamundësisë së vajzës për të pasur një pajë të mirë, si e vetmja mënyrë për t'iu kundërvënë rreptësisë dhe fanatizmit të zakoneve të kohës. Një sërë elementësh të botës kozmike përbëjnë pajën e vajzës: *dielli* si kezë VP apo si pajë VPP, *hënëza* si veshje VP, VPP, *ilëzit* si stoli. Tek varianti i De Radës RPA, RN gjejmë *drita* si veshje, *rreth e qiellit* (ylberin) si brez, *ilzit* si karficat me të cilat fiksohet keza (diadema) në kokën e vajzës. Përpara një paje të tillë djaloshi bindet dhe zemërthyer e merr vajzën për dore dhe e çon në pallatin e tij. Një pallat i madh me 25 dritare e në seicilën prej tyre qëndronte një pëllumb (lumbardhë). Në variantin e De Radës numri i dritareve dhe pëllumbave është 300. Këta pëllumba janë të lidhur me shpirtin e djaloshit. Vajza duhej të kujdesej mirë për ta, t'i ushqente e t'u jepte ujë çdo të shtunë e çdo të diel t'i numëronte. Nuk duhej të humbiste asnjë sepse humbja e çdo lumbardhe do t'ia afronte më shumë orën e vdekjes djaloshit.

Përzgjedhja e pëllumbit si shpendi të cilit i është besuar shpirti është simbolike. Përveç se simbol i Shpirtit të Shenjtë, simbol i paqes, i harmonisë (sjellëse e degës së ullirit Noes), ai përfaqëson shpirtin e njeriut të drejtë, të pastër. Pëllumbi kërkon shoqëri. Sakrifikimi i pëllumbit ka si qëllim të shlyejë padijen dhe neglizhencën. Megjithë kujdesin e madh të saj nusja e re nuk ia del dot. Pëllumbat (*lumbardhat* RPA, RN, *ajo e kuqja, kriebardha pentërgjënta* VP, *kriearëti e pentërgjënti* VPP) largohen të gjithë njeri pas tjetrit, pas të shoqit, duke e lënë vajzën në një lëngim pa shpëtim e në një pritje pa mbarim. Ajo u tret e u shua si një qiri duke lënë për shumë mote pallatin të shkretë.

Varianti i De Radës (RPA, RN) përmban 50 vargje, varianti i paplotë i Santorit 27 vargje ndërsa varianti i plotë i tij 70 vargje. Ky i fundit është dukshëm më i plotë, më i pasur në figura letrare, më shpjegues i ngjarjeve që ndodhin e që do të ndodhin. Verifikohet edhe këtu ajo që edhe studiues të tjerë e kanë vënë re: nga njëra anë tendenca e Santorit për të kaluar

Qasje variantistike ndaj një kënge popullore arbëreshe: “Shkoj një trim...

natyrshëm nga njëra ngjarje tek tjetra, me një zgjerim të informacionit dhe tendenca e De Radës për t’u kufizuar tek një element duke i dhënë vend më shumë përfytyrimit të lexuesit¹⁷.

Dy variantet që trashëgojmë nga Santori, na bëjnë të ditur faktin e ripunimit të këngës, zgjerimit, pasurimit me figuracion letrar ose siç shprehet vet ai “*ntreqa mpero, ngjata e vura mbë drit më të shkëllqeme*. Nga ana tjetër De Rada i mbetet besnik prirjes së gjithhershme të tij për të ndërhyrë (*po pat [t’] veja tue goditur me i nxierr të shtuamet*) e për të redaktuar shkrimet që i besoheshin atij.

Shtojca nr. 1 Transkriptime të varianteve të këngës hartuar nga Santori¹⁸:

	Varianti i plotë (VP)	Varianti i paplotë (VPP)
	Kënëkë	Kënëkë
	Shkoi një trim ka një rûg Me frushërëzen ndë dorë. Ju përpoq je ¹⁹ bardhullore Kuqullore, e bukurë keq 5 Një kopile mesholle. Nkrëjti ai frushërëzën E m’i nkau këshetëthin. Ntodhi e jëma ndë dritësore Pā çë bëri trimëthi 10 Muorë ajo të thoj atij: “Trim çë nkave timen bil Mos nk’e dije, xëje ani Ësht kjo gruaja jote.” “Ndo s’kā pal si t’e dua? 15 Taksëm palën e je marr.” Palën i taksi jëmëza	Shkoj një trim ka një rûg Me baketëzë ndë dorë Ju përpoq e bukurëza Më nkrëjti baketëzën E m’i nkau këshetëthin Ntodhi e jëma ndë finestërë: “Trim çë nkave timen bil Ti prë grua ke t’e marrëçë”, “Taksëm palën se t’e marr”, Pal i taksi diellin Ilëzit prë stoli, Hënëzën prë vantile. Trimi e muori duorshi.. E m’e qelli ndë pullas. Bukurë e uli ndë një shëg Ndë jetrën ju ul vet.

¹⁷ Shih për më shumë: Anton Nikë Berisha, “Mbi dorëshkrimin e Rapsodive të Françesk A. Santorit” në *Atti del 2o Seminario internazionale di Studi Albanesi-Aktet e Seminarit të dytë ndërkombëtar për studimet shqiptare*, a cura di Francesco Altamari con la collaborazione di Giovanni Belluscio, f. 18.

¹⁸ Transkriptimet e të gjitha varianteve të këngës të përfshira në këtë botim janë tonat.

¹⁹ *je* e shtuar mbi rresht zëvendëson *një* të fshirë nga Santori

	I vū kez dielin, Prë vantage hënëzën Prë stolī ilëzit	Bukurë rrij e më i thoj Se “je bukurëza ime Kamë njëzet e pes finestra Me njëzet e pes llumbarda.
20	Trimi e muori duorshi Më je qelli ndë pëllas Më je uli ndë një thronë Ndë të jetrën uli vet. Pa zū hollë të m’e porsij:	Ka të shtunë të m’i potisëçë M’i potisëçë e m’i tagjisëçë ka të diellë t’i nëmërosh. J’erdh e diella menat Zuri fillë t’i nëmëroj
25	“Se je bukurëza ime Ësht i gjerë kī pëllas, Ësht i gjerë e është i thellë Sa i lart, edhe i gjat. Kā njëzet e pes dritore	Më ji miri m’i mankoj Kriearëti, e pentërgjëti
30	Me njëzet e pes llombarda. Ka të shtunë ti m’i tagjis M’i tagjis, e m’i potis, Ka të diellë m’i nëmëro.	
35	Një i vet çë të mankonjë U ²⁰ pa gjellë, e tij pa shoq Nje bën’e qëntronjëmi.” Vasha me një kurë të madhe Vej e vij ndë dritësore, Po të shih llumbardazit	
40	Erdh je diella manat; Zuri fillë t’i nëmëroj, më e mira ji mankoj, Kriebardha pent ërgjënta. “Popo! Popo! Fanë i keq”	
45	Thirri vasha je helmore “Çë t’i thom u timit zot Kurë të vinjë ndë mbrëmjet?” Erdh je mbrëma e zoti i saj Nënk u duk, e nënk u mbjodh.	
50	Vasha qajti e më ju nkeq. Priti ashtu javën e parë Helëmore, e merëngore. Kurë je dita diellë arvoi	

²⁰ u e shtuar mbi rresht zëvendëson *mua* të fshirë nga Santori.

Qasje variantistike ndaj një kënge popullore arbëreshe: “Shkoj një trim...”

- 55 E llombardat nëmëroi
Më mankonej jetëra.
Mbhatu ajo e kuqja.
Ndë njëzet e pes jav
Njera pas jetërën
Gjith llombardat u spovistin
60 E je mjerëza kopile
Prë rëkim e prë shërtim²¹
Çë më bëri nd’ aq mot
Dit prë dit më u nkeq
Si qiria tek lartari.
65 Pak e pak m’u gris e u shua.
Pati pllasin prë varr
Qeramidhet prë mbuluome
Qatërë e gjerë, motin të gjat.
70 Pllasi që më vjet i shkret.

Shtojca nr. 2. Transkriptime të varianteve të këngës hartuar nga Santori dhe De Rada:

Varianti i plotë (VP)

Variant i De Radës (RPA)²²

Kënekë

Canto XIII

- | | | |
|---|--|---|
| 5 | Shkoi një trim ka një rûg
Me frushërëzen ndë dorë.
Ju përpoq je bardhullore
Kuqullore, e bukurë keq
Një kopile mesholle.
Nkrëjti ai frushërëzën
E m’i nkau këshetëthin.
Ntodhi e jëma ndë dritësore | Shkōj një trim ka një rûg
Me frushërëzen ndë dōr ²³ .
Ju përpoqë te një kopile; ²⁴
Ngrëjti ai frushërëzën ²⁵
E m’i nkau këshetëthin.
Ntodhi jëma dritësore.
-Trim që nkave time bil
Mos nk’e dije, xëje nani, ²⁶ |
|---|--|---|

²¹ *Shërtim* e shtuar mbi rresht zëvendëson fjalën *dhëmpim* të fshirë nga Santori.

²² Në shënimet në fund të faqes po paraqesim ndryshimet e bëra nga De Rada në variantin e RN, kënga IX, f. 81-82.

²³ RN v2: me një thupërz ndë dorë

²⁴ RN v3: ju përpoq te një kopile

²⁵ RN v4: ngrëjti ai thupërzën

²⁶ RN v8: mos m’e dije, xëje nani

- Pā çë bëri trimëthi
10 Muorë ajo të thoj atij:
“Trim çë nkave timen bil
Mos nk’e dije, xëje ani
Ësht kjo gruaja jote.”
“Ndo s’kā pal si t’e dua?
15 Taksēm palën e je marr.”
Palën i taksi jëmëza
I vū kez dielin,
Prë vantile hënëzën
Prë stolī ilëzit
20 Trimi e muori duorshi
Më je qelli ndë pëllas
Më je uli ndë një thronë
Ndë të jetrën uli vet.
Pa zū hollë të m’e porsij:
25 “Se je bukurëza ime
Ësht i gjerë kī pëllas,
Ësht i gjerë e është i thellë
Sa i lart, edhe i gjat.
Kā njëzet e pes dritësore
30 Me njëzet e pes llombarda.
Ka të shtunë ti m’i tagjis
M’i tagjis, e m’i potis,
Ka të diellë m’i nëmëro.
Një i vet çë të mankonjë
35 U pa gjellë, e tij pa shoq
Nje bën’e qëntrojnëmi.”
Vasha me një kurë të madhe
Vej e vij ndë dritësore,
Po të shih llumbardazit
40 Erdh je diella manat;
Zuri fillë t’i nëmërōj,
Më e mira ji mankoj,
Kriebardha pent ërgjënta.
“Popo! Popo! Fanë i keq”
- Një kopil çë nket një vash,
Kā t’e marr ai për grua”.²⁷
-Taksēm palën e je marr”.²⁸
Palen më i taksi jëma:
Për xilōn dritjen,
Rreth e qiellit për brez,
Spingullat kë i vū te keza,
Iliz mār n’qiellshit.
E m’u ndreqi e m’e pastroi
Prana trimit ja e dërgoi.
Trimi e muar për dorje
E m’u vu e m’e porsinej:
-Shihēm shpīn e bukura;
Ka treqint dritësore
Me nj’atër aqë llumbardha,
Ndër duart [t]ënde gjith i vë.
Nka t’shtūn ti m’i tagjis
M’i tagjis e m’i potis,
Nka të diel m’i nëmëro:
Se aqë më bierën sa t’ lipsen”.
Vasha e gjegji me tërbim.
Vej e vij finestrashit
Kur j’erdhi e diela
Zū fill t’i nëmrōj,
Më e mira je mankoj.
“-Çë t’i thom u zotit [t]im’
Kur të vinj sontenith?”
Erth po mbrëmja e zoti saj
Nënk u duk e nënk u mbjodh
Vasha klajti e sherëtoi,
As la po me e pritur.
Zogjët tagjisi e potisi
Një për një të shtūn mbrëma,
Mori e diela kur u dih,
E llumbardhat nëmëroi
Pā se jatëra mankoj.

²⁷ RN v10: do t’e marr ai për grua

²⁸ RN v11: taksi palen e j’marr

Qasje variantistike ndaj një kënge popullore arbëreshe: “Shkoj një trim...

45	Thirri vasha je helmore “Çë t’i thom u timit zot Kurë të vinjë ndë mbrëmjet?” Erdh je mbrëma e zoti i saj Nënk u duk, e nënk u mbjodh.	Jāv pas javje Gjith fjeturuan e vān Pas të zōn e saj për mōn. Ajo e nd’ato sāl të veta Ditë pas ditje u los
50	Vasha qajti e më ju nkeq. Priti ashtu javën e parë Helëmore, e merëngore. Kurë je dita diellë arvoi E llombardat nëmëroi	E m’u shua si një qirī. E m’u shua si një qirī.
55	Më mankej jetëra. Mbajtu ajo e kuqja. Ndë njëzet e pes jav Njera pas jetërën Gjith llombardat u spovistin	
60	E je mjerëza kopile Prë rëkim e prë shërtim Çë më bëri nd’ aq mot Dit prë dit më u nkeq Si qiria tek lartari.	
65	Pak e pak m’u gris e u shua. Pati pllasin prë varr Qeramidhet prë mbuluome Qatërë e gjerë, motin të gjat.	
70	Pllasi që më vjet i shkret.	

BIBLIONETGRAFIA E SHFRYTËZUAR

- Altimari, F. (përgatitur nga): Jeronim de Rada, *Vepra letrare I, Këngët para Millosaut-I canti premilosaici (1833-1835)* Sprovat e para poetike të Jeronim De Radës. Botim kritik e përkthime italisht përgatitur nga Francesco Altimari, Tiranë, 2014
- Belmonte, V. (a cura di): Opere di Francesco Antonio Santori, *Rapsodīt*, a cura di Vincenzo Belmonte, botim elektronik, 2013. <http://www.albanologia.unical.it/FrancescoAntonioSantori/Opere/Opere%20varie/2%20Le%20Rapsodie.pdf> etj.
- Berisha, A. N.: “Mbi dorëshkrimin e Rapsodive të Françesk A. Santorit” në *Atti del 2o Seminario internazionale di Studi Albanesi-Aktet e Seminarit të dytë ndërkombëtar për studimet shqiptare, Rende,*

- Shën Japku Strigari*, 8-10 qershor 1994, a cura di Francesco Altimari con la collaborazione di Giovanni Belluscio. Botuar në Quaderni del Dipartimento di Linguistica, n.14, Università della Calabria, f. 15 - 22.
- Camarda, D.: *Appendice al saggio di gramatologia comparata sulla lingua Albanese*, per Demetrio Camarda, Prato, Tip. F. Alberghetti e C, 1866.
- Çeta, A. & Berisha, A. N. (përgatitur nga): Jeronim de Rada, *Vepra 5 – Rapsodi të një poeme shqiptare*. Mbledhur në kolonitë e rrethit të Napolit. Translitteruar dhe përgatitur për shtyp nga Anton Çeta e Anton Berisha, Prishtinë, Rilindja, 1983.
- De Rada, G.: *Rapsodie di un poema albanese raccolto nelle colonie del napoletano*. Firenze, Tipografia di Federigo Bencini, 1866.
- De Rada, G.: *Biblioteca Albanese, Rapsodie Nazionali, Prefazione. Appendice al Fiamuri Arbërit (1883-1887) Shih edhe Rapsodie Nazionali - Libro Terzo në:*
<http://www.albanologia.unical.it/GirolamoDeRada/opere%20deradiane/a%20stampa/Rapsodie%20nazionali.pdf>
- De Rosa, F. (përgatitur nga): Jeronim de Rada, *Vepra letrare V, Rapsoditë Kombëtare - Rapsodie Nazionali*, botim kritik i dy varianteve përgatitur nga Fiorella De Rosa, Tiranë, 2014.
- Ferrari, G.: *Canti albanesi*, Raccolta di Michele Bellusci del '600, Bari, Adriatica Editrice, 1963
- Fetihu, S.: *Balada popullore shqiptare*, Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2000.
- Fortino, I. C., “Girolamo de Rada ad Angelo de Gubernatis” në përmbledhjen *Omaggio a Girolamo De Rada, Microprovincia*, gennaio dicembre 2003. n. 41, f. 179 – 255.
- Mandalà, M.: “Për botimin e veprës letrare të Françesk Anton Santorit. Disa probleme ekdotike paraprake” në *Studime filologjike për letërsinë romantike arbëreshe*, Tiranë, botimet Naimi, 2012.
- Haxhihasani, Q. (përgatitur nga): *Balada popullore shqiptare*, Tiranë, Sh. B. “Naim Frashëri”, 1982
- Haxhihasani, Q. (përgatitur nga): *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)*, vëllimi I, redaktuar nga Qemal Haxhihasani f.126 – 201.
- Marchianò, M. (a cura di): *Canti popolari albanesi delle colonie d'Italia*. Pubblicati da un manoscritto della prima metà del secolo XVIII

Qasje variantistike ndaj një kënge popullore arbëreshe: “Shkoj një trim...”

con traduzione juxtalineare da Michele Marchianò. Foggia, Tipografia Francesco Paolo De Nido, 1908.

Neziri, Z.: *Lirika gojore shqiptare*, Shkup, Interlingua, 2015.

Schirò, G.: *Canti tradizionali ed altri saggi delle colonie albanesi di Sicilia*, Napoli, Stab. Tip. Luigi Pierro & Figlio, MCMXXIII.

Sejko, V.: *Mbi elementet e përbashkëta në epikën shqiptaro-arbëreshe dhe serbokroate*, Tiranë, Bargjini, 2002

Tocci, E.: “Su alcuni canti popolari inviati da F. A. Santori al De Rada” në *Atti del 2o Seminario internazionale di Studi Albanesi-Aktet e Seminarit të dytë ndërkombëtar për studimet shqiptare Rende, Shën Japku Strigari*, 8-10 qershor 1994, a cura di Francesco Altimari con la collaborazione di Giovanni Belluscio. Botuar në Quaderni del Dipartimento di Linguistica, n. 14, Università della Calabria, f. 73 - 94.

Tradizioni orali non cantate-primo inventario nazionale per tipi, motivi o argomenti. Ministero dei Beni Culturali e Ambientali, Roma 1975.

